

BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Prill 2026

www.cp-project.al info@cp-project.al



Aktivite ndërgjegjëse ne Tirane, nga Skema e Granteve mbi sigurinë rrugore

Dy aktivitete ndërgjegjëse mbi sigurinë rrugore u zhvilluan në Tiranë gjatë prillit 2026 nga Kuratoriumi për Sigurinë Rrugore (KRS), në kuadër të Programit SCPA dhe me mbështetjen e institucioneve arsimore e policore:

15 prill 2026 – Gjimnazi “Ismail Qemali”

Aktiviteti i parë me sloganin “Unë i respektoj rregullat e qarkullimit rrugor. Bëje dhe ti!”.

- Temat: përdorimi i rrugës nga këmbësorë, çiklistë, motoçiklistë e drejtues mjete; parimet bazë të qarkullimit; shkaqet dhe parandalimi i aksidenteve; edukimi dhe normat e sjelljes; rëndësia e rripit të sigurimit dhe kaskës.
- Nxënësit përjetuan një **simulim aksidenti**, duke kuptuar praktikisht rolin jetik të rripit të sigurimit.

23 prill 2026 – Gjimnazi “Sami Frashëri”

- Aktiviteti i dytë, me fokus tek maturantët si gjeneratë e re që pritet të përmirësojë kulturën e sjelljes në rrugë.
- Temat: Informim mbi kufizimet ligjore për drejtuesit e rinj të automjeteve (fuqia specifike

e mjetit ≤ 55 kW/ton; për automjetet hibride ≤ 65 kW/ton).

- Diskutim mbi pasojat e drejtimit pa leje, duke theksuar sanksionet administrative e penale.
- Demonstrim praktik me **automjetin simulator të KRS-së**, për të provuar rëndësinë e rripit të sigurimit gjatë drejtimit.

Në thelb, të dy aktivitetet synuan **rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për sigurinë rrugore**, respektimin e rregullave dhe parandalimin e aksidenteve, duke kombinuar **informim teorik me përvoja praktike**.



AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Aktivitete ndërgjegjëse ne Tirane, nga Skema e Granteve mbi sigurinë rrugore
- ◆ Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe Stafit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtoria Vendore e Policisë Korçë
- ◆ Seminar mbi ‘Aspektet Psikologjike të Fushatave të Ndërgjegjësimit’
- ◆ Aktivitet nga Skema e Granteve – KVSP dhe Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet – Shkodër dhe Elbasan
- ◆ Aktivitet nga Skema e Granteve – Gjirokastrë dhe Fier
- ◆ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe personelit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – DVP Korçë



Në datat **14-16 prill, 21-23 prill dhe 28-30 prill 2026**, 3 grupe të përberë nga **Oficerë të Patrullës së Përgjithshme** dhe personel të **Sallës së Komandës dhe Kontrollit të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë** morën pjesë në një trajnim të organizuar nga **Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA**, i zhvilluar në ambientet e komisarariatit Korçë. Numri i pjesëmarrësve ishte në total 69 Punonjës policie

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit u njohën si me pjesën teorike ashtu edhe me ushtrimet praktike dhe me punën në grup, duke u fokusuar në filozofinë e Policimit në Komunitet dhe

zbatimin e elementeve të saj në punën e përditshme të oficerëve të Policisë së Shtetit.


Gjithashtu, atyre iu prezantuan situata/ushtime praktike për t'u trajtuar dhe zgjidhur prej tyre teksa punuan në grup me synimin për të siguruar masat që duhen marrë në mënyrë proaktive për zbatimin e elementeve të Policimit në Komunitet.

Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të rasteve të Dhunës në Familje si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik. Me qëllim për të

ofruar module trajnimi gjithëpërfshirëse, ekipi i Programit SCPA bashkëpunoi me **Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**, ekspertët e së cilës ofruan leksione ndërvepruese mbi luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Praktikat më të mira të BE-së për zbatimin e filozofisë së PK u ndanë e shkëmbyen me oficerët e PSH. Në përfundim të këtij trajnimi, oficerët e PSH arrijnë të përmirësojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për zbatimin e Policimit në Komunitet. oficerëve të Policisë së Shtetit,

Seminar mbi 'Aspektet Psikologjike të Fushatave të Ndërgjegjësimit'



Më **02-03 Prill 2026**, Ndhmës Specialistët për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë morën pjesë në një seancë trajnimi të fokusuar në aspektet psikologjike të angazhimit dhe edukimit të nxënësve të shkollave gjatë fushatave të ndërgjegjësimit nëpërmjet moduleve përkatëse. Trajnimi u zhvillua nga Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA në bashkëpunim me Drejtorinë e Rendit Publik të Policisë së Shtetit.

Trajnimi synoi të forconte kapacitetin e Ndhmës Specialistët për Edukimin dhe

Punën me të Rinjtë për të kuptuar më mirë sjelljen e të rinjve, qasjet e komunikimit dhe teknikat e ndërtimit të besimit kur punojnë me nxënës në shkolla dhe komunitete. Pjesëmarrësit eksploruan metoda praktike për të ofruar seanca ndërgjegjësimi në një mënyrë interaktive, respektuese dhe miqësore për të rinjtë, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe dialogun.

Përmes diskutimeve dhe shembujve praktikë, trajnimi theksoi rëndësinë e ndërtimit të besimit midis policisë dhe

të rinjve, duke përdorur strategji efektive komunikimi dhe duke krijuar një mjedis pozitiv që mbështet parandalimin dhe bashkëpunimin e komunitetit.

Duke përmirësuar këto aftësi, Ndhmës Specialistët për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë do të jenë më të pajisur për të kryer fushata ndërgjegjësimi me ndikim mbi çështjet që prekin të rinjtë, duke nxitur njëkohësisht marrëdhënie më të forta midis policisë dhe komunitetit.

Aktivitet nga Skema e Granteve – KVSP dhe SMSK – Shkodër dhe Elbasan



Më 17 Prill 2026 në Bashkinë Shkodër u zhvillua takimi i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, ku ndër të tjera u bë prezantimi i rezultateve të Sistemit të Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK) dhe nxitjen e diskutimit ndërinstitucional mbi sigurinë publike. Në takim morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme vendore, përfshirë policinë, shërbimet sociale dhe organizata të shoqërisë civile.

Gjatë prezantimit u evidentuan perceptimet e qytetarëve mbi sigurinë dhe problematikat kryesore në komunitet. Përfaqësuesit e Policisë theksuan se disa fenomene, si vjedhjet dhe aktiviteti kriminal, janë në rënje sipas të dhënave zyrtare, ndërsa


diskutimet nxorën në pah rëndësinë e marrjes në konsideratë edhe të perceptimeve të qytetarëve. Në përfundim, u theksua nevoja për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe funksionimin e rregullt të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, si dhe vijimin e analizës së gjetjeve për të përmirësuar sigurinë në komunitet. Zhvillimi i sondazhit të SMSK është kryer në kuadër të Skemës së Granteve të Programit SCPA dhe për qarkun Shkodër është zbatuar nga organizata Gruaja tek Gruaja.

Me datë 14 Prill, 2026-KVSP Elbasan, në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, organizoi një forum rinor të fokusuar në sigurinë publike dhe rolin e të rinjve

në parandalimin e dhunës. Aktiviteti mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, policisë, prokurorisë, organizatave të shoqërisë civile dhe të rinj, duke krijuar një hapësirë të hapur dialogu dhe bashkëpunimi për një komunitet më të sigurt. Në forum ishte i pranishëm edhe Michel Tarran, Ambasador i Prezencës së OSBE në Shqipëri, i cili theksoi rëndësinë e angazhimit të të rinjve në çështjet e sigurisë publike.

Një moment i rëndësishëm i aktivitetit ishte prezantimi i aplikacionit “Raporto Tani”, i zhvilluar nga TVO në kuadër të projektit PARTNER, i cili është i financuar dhe i mbështetur nga Programi Suedez SCPA

Aktivitet nga Skema e Granteve – Fier dhe Gjirokastrë



Qendra Kulturore Multimediatike Antigonea zhvilloi në datë 21 Prill 2026 në Gjirokastrë Takimin Hapës, në kuadër të projektit “Nga ndërgjegjësimi te veprimi: Parandalimi i kulturës së bullizmit në shkollë dhe në komunitet”. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), Bashkia, shërbimet sociale, Policia e Shtetit, punonjës socialë, oficerë sigurie dhe psikologë nga shkollat, duke reflektuar një angazhim të përbashkët për adresimin e fenomenit të bullizmit. Gjatë aktivitetit

u prezantuan objektivat dhe aktivitetet e projektit, si dhe u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për fëmijët dhe të rinjtë.

Më 30 Prill 2026, në shkollën ‘Numani’ në Fier u zhvillua një takim informues dhe ndërgjegjësimi mbi parandalimin e krimit tek të rinjtë. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Skuadra e Sigurisë Publike 2 – Partner për një komunitet të sigurt”, pjesë e Skemës së Granteve të Programit SCPA, e zbatuar nga organizatat “Epoka e Re” në

bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier. Qëllimi i aktivitetit ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve mbi pasojat e shkeljes së ligjit, si dhe roli i tyre dhe i komunitetit në parandalimin e krimit. Në takim morën pjesë përfaqësues nga DVP Fier dhe Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Fier. Pjesëmarrësit theksuan se bullizmi mbetet një ndër sfidat më të ndjeshme që prek mirëqenien emocionale, sociale dhe arsimore të fëmijëve dhe të rinjve. komunikim pozitiv në shkollë dhe në komunitet.

NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, “Për zbatimin e Programit ‘Siguria e të Rinjve’ në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike,” Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **Prill 2026**.

Objektivi kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatorët vendorë të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda zonave të tyre policore. Gjatë muajit Prill, fokusi i veçantë ka qenë te temat

e ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore te cilat përbëjnë prioritetet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisariatet e qyteteve **Tiranë, Berat, Kurbin, Fier, Lushnje, Durrës, Shkodër, Lezhë, Korçë, Pogradec, Gjirokastrë, Elbasan, Kukës, Vlorë dhe Sarandë,**

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **344** materiale dhe aktivitete që janë parë në mënyrë interaktive nga **4611** përdorues, duke

dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **123** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përshëndetëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

